Dt. 25.01.2024

Proçes-verbal i mbajtur sot më datë 25.01.2024, ora 13:00, në sallën e mbledhjeve pranë Bashkisë Cërrik. Në mbledhje morrin pjesë Kryetari i Bashkisë Z. Andis Salla dhe Këshilltarët:

| | |
|---|---|
| 1- Besnik Bingoku | 11- Zegine Dhepa |
| 2- Erona Gjini | 12- Qamil Boja |
| 3- Jetmir Koroshi | 13- Nadire Aslloni |
| 4- Zamira Fahriu | 14- Elton Kumria |
| 5- Adriatik Belshi | 15- Flutura Hoxholli |
| 6- Adi Çepa | 16- Shyqyri Xhika |
| 7- Burbuqe Rofja | 17- Mandi Ploka |
| 8- Elton Ibro | 18- Shyqyri Kamami |
| 9- Pranvera Liçi | 19- Anisa Taçi |
| 10- Asqeri Kibarraku | 20- Gazmira Frakulli. |

Mungon: Erinda Vishkulli

Mbledhja kryesohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak Z. Jetmir Koroshi, i cili konstatoi se në mbledhje morrin pjesë më shumë se gjysma e këshilltarëve dhe këshilli i plotfuqishëm mund të vendos.

Rendi i ditës paraqitet si më poshtë:

1- Pr/Vendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Bllok-Ndihmën (6%)."

2- Pr/Vendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për periudhën 1-31.12.2023."

3- Pr/Vendim: "Për miratimin e kritereve specifike për familjet që do të trajtohen me 6% e fondeve të Bllok-Ndihmës për vitin 2024".

4- Pr/Vendim: "Për miratimin e kritereve specifike për familjet që do të trajtohen me të ardhurat e Bashkisë për vitin 2024".

5- Pr/Vendim: "Për miratimin e planit vjetor të prokurimit

në shërbimin civil."
Josh rendid të ditës:
1- Pr/Vendim: "Për miratimin e ndihmës financiare për familjet në nevojë!"
2- Pr/Vendim: "Për miratimin e vlerës së qirasë për banesat Sociale."
3- Pr/Vendim: "Për miratimin e: 1- Vlerave që përfitojnë familjet nga programi i strehimit "Banes sociale me qira (BSQ)" Subvencionim i qirasë për vitin 2024"
2- Deklarata e Kryetarit të bashkisë për bashkëfinancimin në masën 20% të vlerës së projektit BSQ për familjet përfituese."
Kryesuesi: Kush është dakort me rendin e ditës dhe ndryshimet në të?
Miratohet rendi i ditës me: 20 vota Pro
0 vota kundër
0 vota Abstenim
Pika 1
Znj. Ornela Mehmeti paraqet projektin ku i propozojnë Drejtorisë Rajonale të shërbimit social, të përfitojnë ndihmë ekonomike për muajin Dhjetor 2023, me 6% e fondit të Bllok-Ndihmës 21 familje me një fond prej 95.838 lekë dhe pagesa të kryhet sipas listës emërore, që bashkëlidhet projektit.
Pyetje dhe diskutime? Sko
Miratohet me: 20 vota Pro
0 vota kundër
0 vota Abstenim
Pika 2
Znj. Ornela Mehmeti përgjegjëse pran sektorit social i propozon këshillit Bashkiak të miratojnë projekt-vendimin ku të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e Bashkisë për muajin Dhjetor 2023. 53 familje me një fond prej 272.090 lekë. Ndarja sipas njësive Administrative.
Pyetje dhe diskutime?
Z. Qamil Boja, unë jam kundra, jam i mendimit që kjo si ndihmë të parashikohet dhe pagesa të jetë për persona me emergjenca shëndetsore etj.
Miratohet me: 17 vota Pro
3 vota kundër
0 vota Abstenim
Pika 3
Z. Ornela Mehmeti: Propozon për miratimin e kritereve specifike për familjet që do të trajtohen me 6% e fondeve të Bllok-Ndihmës për vitin 2024. Per këtë vit skemë ndryshime të kritereve. Qëndrojnë po të njëjtat si në vitin që lëm pas. Disa nga kriteret janë:
- Familje në kushte ekstreme varfërie.
- Familje me fëmijë të vegjël të cilat jetojnë në kushte të vështira social ekonomike.
- Familje të cilat kanë përbërje të tyre kryefamiljar-et (vajza-nëna, gra të divorcuara, gra të veja me fëmijë në ngarkim, gra me histori dhune në familje, gra kryefamiljare të më dhe në moshë pa mbështetje nga familja etj.)
- Familje të cilat kanë në përbërje persona me probleme shëndetsore të cilët janë të paaftë për të punuar.
- Familje që mbartin problematika sociale.
- Familje të cilat i përkasin minoriteteve etnike.
- Familje me shumë fëmijë etj.

Kryesuesi : Kush është dakort ?
Miratohet me : 20 vota pro
0 vota kundër
0 vota Apstenim

Pika 4
Znj. Ornela Mehmeti i paraqet Këshillit Bashkiak për miratim kriteret specifike për familjet që do të trajtohen me të ardhurat e Bashkisë për vitin 2024. Znj. Ornela shtoi se në këtë vit kriteret për fondet nuk ndryshojnë. Ato janë si më lart përmendur dhe tek 6% te pika 3.
Kryesuesi : Pyetje dhe diskutime ? S'ka
Miratohet me 19 vota pro
1 vota kundër
0 vota Apstenim

Pika 5
Znj. Rosina Jaupaj, Juriste pranë Bashkisë propozon për miratimin e Planit vjetor të Pranimit në shërbimin civil. Znj. Rosina shtoi se numri i vendeve vakante të planifikuara për reduktim, pjesë e administratës në bashkisë në Total është 22 (njëzet e dy)
Të ndara si më poshtë :
1- Nivel i Lartë Drejtues është 1
2- Nivele i Mesëm Drejtues është 1
3 - Nivel i Ulët Drejtues është 4
4- Nivel ekzekutiv është 16
Kryesuesi : Diskutime ?
Znj. Erona Gjini :- Bëni mir të keni akoma hulje të numrit të punonjësve sepse Bashkia është e mbi ngarkuar nga nr i tyre. Diskutime vazhdojnë në sallën e bledhjes në lidhje me punonjësit e Bashkisë dhe pozicionet e tyre.
Miratohet me : 20 vota pro
0 vota kundre
0 vota Apstenim

Jashtë rendit të ditës :
Pika 6
Zt. Hekuran Kumria, Drejtor i financës i propozon këshillit Bashkiak të miratojnë ndihmën financiare për familjen e Znj. Olivia Dora, Z. Hekuran shton se bëhet fjalë për fëmijën e zonjës në fjal, i cili është i sëmurë me tumor në kokë dhe duhet me patjetër të bëj një ndërhyrje kirurgjikale. Familja ndodhet në kushte të vështira ekonomike dhe nuk i përballon dot shpenzimet. Ne kemi menduar si bashki t'ju propozojmë vlerën 100000 lekë.
- Z. Mond Plaka :- Jam shumë dakort, mundësisht ne t'ja shtojmë sepse jam në dijeni të rastit. Ky rast është bërë dhe mediatik ku kërkojnë ndihmë. Un vet do i afroj një ndihmë simbolike. Diskutime në sallë për ardhjen në ndihmë të fëmijës.
Miratohet me : 20 vota pro
0 vota kundër
0 vota Apstenim

Pika 7
Znj. Suzana Frakulli, punonjëse pran Urbanistikës i propozon Këshillit të miratojnë vlerën e Qirasë për $m^2$, për banesat sociale si më poshtë:
1- shkolla e Notës 70 lekë / $m^2$
2- Shtëpia e Pionerit 56 lekë / $m^2$

3- Objekti dy katë magazinë 77 lekë /m2
4- Qeramonësi me lidhjen e kontratën, është i detyruar të paguaj paradhënie, në formë garancie në vlerën e një qiraje mujore.
Miratohet me : 20 vota Pro
0 vota Kundër
0 vota Apstenim.

Pika 8
Znj. Suzana Frakulli propozon të miratoj në Vlerat që përfitojnë individët / familjet nga Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë për vitin 2024. Lista mbyllet me nr. 33 (tridhjetë e tre) individ / familje dhe shuma totale që përfitojnë është 2421980 lekë (80% nga Buxheti i shtetit, në vlerën 1937584 lekë dhe 20% nga Buxheti i Bashkisë në masën 484396 lekë)
2- Të miratojë Deklaratën e Kryetarit të Bashkisë për bashkëfinancim në masën 20% të vlerës në projektit BSQ (subvencionim qiraje) për familjet përfituese.
Pyetje dhe diskutime?
Znj. Gazmira Frakulli: këta janë zgjedhur nga ne?
Znj. Suzana: - këta janë aplikant që e kanë bërë në Zonën aplikimin.
Miratohet me : 20 vota Pro
0 vota Kundër
0 vota Apstenim

Kryesuesi: Duke ju falenderuar për prezencën mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Në këtë mbledhje u miratuan 8 (tetë) vendime. Mbledhja përfundoi në orën 15:15 min.
Sekretare e Këshillit Bashkisë
Edije Asllani [signature]

Osmil Bojo [signature]
Zegine Dhepa [signature]
Shyqyri Dhiko [signature]
Shyqyri Kamani [signature]
Pranvera Lisi [signature]
Zamira Fakaiu [signature]
Nadire Asllani [signature]
Burbuqe Gafe [signature]
Elton Ihumrija [signature]
Gazmira Frakulli [signature]
Erona Gjini [signature]
Agron Morava [signature]
Besnik Bajo [signature]
Elton Bejko [signature]
Admir [signature]
Anisa Taçi [signature]
Flutura Hoxholli [signature]